



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 5698/Prot.

Elbasan, më 16.01.2022

LËNDA : Kthim përgjigje.

QENDRËS "RES PUBLICA"

Adresa: Blv. Gjergj Fishta, Nd.24, H.3, Ap.7

TIRANË

Në përgjigje tuajës nr.202/22, datë 02.12.2022, me lëndë "Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit", administruar në protokollin e bashkisë Elbasan nr.5698, datë 05.12.2022.

Në mbështetje të:

- Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjit nr.57 datë 30.04.2020 "Për Pyjet";
- Ligjit nr.119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit";
- VKM nr.433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", i ndryshuar.

Ju informojme si me poshtë vijon:

1. A ju është marrë mendim për rishikimin e kufinjëve të zonës së mbrojtur para miratimit të VKM_së nr.59, datë 26.01.2022 "Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore"?


Nga struktura e administrimit të pyjeve dhe kullotave pranë bashkisë Elbasan **nuk** është marr asnjë mendim/opinion në lidhje me rishikimin e kufinjëve të zonës së mbrojtur para miratimit të VKM_së nr.59, datë 26.01.2022.

2. Nëse po, kopje të mendimeve/opinioneve të dhëna nga institucioni juaj në lidhje me këtë - VKM.

Kjo pikë është ezauruar me përgjigjen e pikës 1.

Faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV.KRYETARI
Aulona Bylykbashi

KRYETARI
Gledian Llatja